

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026



## KËRKESË PËR TENDER (KPT)

### 1. Informacion i Përgjithshëm

**1.1. Oferta e kërkuar nga:** Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit: Rruga "SH81", Parku Kombëtar i Butrintit, Ksamil, Shqipëri.

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit (FMB) është një organizatë jofitimprurëse pa anëtarësi, e bashkëthemeluar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit (MTKS) dhe Fondacioni Shqiptar-Amerikan për Zhvillim.

FMB operon në fushën e trashëgimisë kulturore dhe ka për qëllim administrimin indirekt të nënzoneve të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e PKB (“**Pasuria Kulturore**”), në përputhje me Marrëveshjen e miratuar me Ligjin 50/2022 “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzoneve të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit”.

**1.2. Objekti i Kërkesës për Tender:** Kryerja e punimeve “*Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit*”, ref. 007 / 2026. Më shumë detaje gjenden në projekt dhe Specifikimet Teknike, pjesë e pandarë e Kërkesës për Tender.

**1.3. Burimi i financimit dhe fondi limit:** Kjo Kërkesë për Tender financohet nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit. Fondi limit për këtë KPT është: 57,800,815 Lekë (me TVSH).

**1.4. Mashtrimi dhe Korrupsioni:** Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit kërkon që furnitorët, kontraktorët dhe konsulentët sipas kontratave të tij ose kontratave të tilla të kërkuara, të respektojnë standardet më të larta të etikës gjatë prokurimit dhe ekzekutimit të kontratave. Në ndjekje të një politike të tillë, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit përcakton për qëllimin e kësaj dispozite, kushtet e përcaktuara si më poshtë:

- a- “Praktikë korruptive” nënkupton ofertën, dhënien, marrjen ose kërkimin e çdo gjëje me vlerë për të ndikuar në veprimin e punonjësve apo drejtuesve të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit në procesin e prokurimit ose në ekzekutimin e kontratës.
- b- “Praktikë mashtruese” nënkupton një keqinterpretim të fakteve me qëllim që të ndikojë në një proces prokurimi ose ekzekutimin e një kontrate në disfavor të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit dhe përfshin praktikën e fshehta të marrëveshjeve të paligjshme midis Ofertuesve (para ose pas paraqitjes së Ofertave) të krijuara për të përcaktuar çmimet e Ofertave në nivele artificiale, jo konkurruese dhe t'i privojnë Fondacionit përfitimet e konkurrencës së lirë dhe të hapur.

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të refuzojë një ofertë nëse konstaton se Ofertuesi është përfshirë në praktika korruptive ose mashtruese në konkurrim për kontratën. Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit do të deklarojë gjithashtu një entitet si të papërshtatshme për t'i dhënë një kontratë, qoftë për një kohë të pacaktuar ose për një periudhë të caktuar kohore, nëse konstaton se entiteti është përfshirë në

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

praktika korruptive ose mashtruese në konkurrim ose në ekzekutimin e një kontrate të financuar nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit.

Ndalohet kontakti i drejtpërdrejtë me punonjësit ose drejtuesit e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit në lidhje me paraqitjen e ofertave gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave.

Çdo përpjekje e Ofertuesve për të ndikuar përfaqësuesit e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit në vlerësimin e ofertave ose vendimeve për dhënien e kontratës do të rezultojë në refuzimin e menjëhershëm të ofertave të tyre.

### 1.5. Pranueshmëria e Ofertuesve: Ofertuesit nuk mund të konkurrojnë nëse:

- 1- Nuk janë kompani të regjistruara.
- 2- Janë të falimentuar ose në proces falimentimi / likuidimi.
- 3- Kanë qenë fajtorë për shkelje të rënda profesionale, përfshirë keqinterpretimin serioz në dhënien e informacionit dhe shkeljen e detyrimeve të tyre kontraktuale.
- 4- Nuk kanë përbushur detyrimet lidhur me pagesën e sigurimeve të detyrueshme, sigurimet shoqërore dhe taksat.
- 5- Janë në ndonjë listë të subjekteve të sanksionuara të lëshuara nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara, Kombet e Bashkuara ose Bashkimi Evropian ose Agjencia e Prokurimit Publik.
- 6- Janë në konflikt interesi. Një Ofertues konsiderohet të ketë konflikt interesi në rast se, por nuk kufizohen: (i) ka një marrëveshje kompensimi ose interes tjetër në një transaksion me Fondacionin; (ii) ka një rrethanë tjetër që, në fakt ose në dukje, mund ta vështirësojë ushtrimin e pavarësisë, gjykimin objektiv ose në ndonjë mënyrë tjetër kryerjen me efektivitet të detyrave si kontraktor; (iii) ka të njëjtin drejtues ligjor me një Ofertues tjetër; (iv) ka marrë pjesë në hartimin e projektit dhe specifikimeve teknike të procedurës në fjalë; (v) ka lidhje familjare ose biznesi me stafin e Fondacionit.
- 7- Një Ofertues mund të jetë një subjekt i vetëm ose një bashkim subjektësh sipas një marrëveshjeje ekzistuese ose sipas një letre qëllimi e shoqëruar me një marrëveshje për krijimin e një bashkimi subjektësh në rastin e shpalljes fitues. Një Ofertues që vendos të konkurrojë i vetëm ose si bashkim subjektësh nuk duhet të dorëzojë më shumë se një ofertë. Në një rast të tillë, të gjithë ofertat do të refuzohen.
- 8- Në rastin e bashkimit të subjekteve ose qëllimit për të krijuar një bashkim subjektësh, numri i subjekteve anëtarë të bashkimit nuk duhet të jetë më shumë se dy. Të gjithë anëtarët e bashkimit të subjekteve do të jenë bashkërisht dhe vecmas përgjegjës për ekzekutimin e kontratës. Bashkimi i subjekteve do të caktojë një përfaqësues, i cili do të jetë i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet për dhe në emër të bashkimit të subjekteve gjatë procesit të prokurimit dhe ekzekutimit të kontratës, në rast se shpallet fitues.
- 9- Janë sanksionuar për mashtrim dhe korrupsion, sipas pikës 1.4, nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara, Kombet e Bashkuara ose Bashkimi Evropian ose Agjencia e Prokurimit Publik.
- 10- Mos plotësimi i kriterëve të tjera kualifikuese.

## 2. Përmbajtja e Dokumenteve të Tenderit:

**2.1. Dokumentet e Tenderit:** Dokumentet e Tenderit merren nëpërmjet kërkesës me email në [tenders@bmf.al](mailto:tenders@bmf.al) nga faqja zyrtare e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, <https://bmf.al/>. Nëse keni pyetje, ato duhen drejtuar me shkrim me e-mail në [tenders@bmf.al](mailto:tenders@bmf.al) ose me shkresë në adresën e mësipërme. Format e tjera të komunikimit në lidhje me ofertat nuk pranohen gjatë një procedure në vazhdim.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

Të gjithë Ofertuesit do të marrin dokumente identike. Fondacioni nuk mban përgjegjësi nëse dokumentet e tenderit nuk merren direkt nga adresa e sipërcituar. Asnjë Ofertues nuk duhet të shtojë, heqë ose ndryshojë ndonjë term ose kusht në dokumentet origjinale. Nëse e bëjnë, kjo do të jetë arsye për skualifikim të menjëhershëm.

## 2.2. Përmbajtja e dokumenteve të Tenderit: Dokumentet e Tenderit përbëhen nga:

- Kjo Kërkesë për Tender,
- Termat e Referencës,
- Formularët e Ofertës,
- Specifikimet teknike,
- Grafiku i punimeve,
- Projekti i zbatimit,
- Relacioni Teknik,
- Draft kontrata
- Formularët e kontratës.

**2.3. Vizitë në terren:** Çdo Ofertues mund të vizitojë dhe inspektojë vendin në tërësi përpara se të bëjë dhe dorëzojë një Ofertë, me shpenzimet e veta dhe nën përgjegjësinë e tij të plotë. Ofertuesit e interesuar mund të kryejnë vizitat në terren deri më datë 12 Qershor 2026, duke i dërguar një njoftim paraprak Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit në adresën e emailit [tenders@bmf.al](mailto:tenders@bmf.al) mbi datën e vizitës dhe numrin e personave pjesëmarrës.

**2.4. Sqarimi i dokumenteve të tenderit:** Sqarimet në lidhje me dokumentin e tenderit duhet t'i dërgohen me shkrim Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit jo më vonë se gjashtë ditë pune përpara afatit të dorëzimit. Kërkesat mund të dërgohen me e-mail në [tenders@bmf.al](mailto:tenders@bmf.al) ose të dërgohen me shkrim në zyrën e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit në Sarandë. Përgjigjet për çdo pyetje të ngritur nga çdo Ofertues do t'i jepen me shkrim, nëse është e mundur, brenda tre ditëve të punës, të gjithë Ofertuesve të interesuar, pa identifikuar Ofertuesin që ka kërkuar sqarimin. Megjithatë, është kusht i kësaj Kërkese për Tender që asnjë sqarim nuk do të konsiderohet se zëvendëson, kundërshton, shton ose pakëson kushtet e saj, përveç nëse ndryshimet bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga Drejtori Ekzekutiv ose përfaqësuesi i tij i caktuar.

**2.5. Ndryshimi i Dokumentit të Tenderit:** Në çdo kohë para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit mund të ndryshojë Dokumentin e Tenderit duke lëshuar një shtesë. Çdo shtesë e lëshuar do të jetë pjesë e Dokumentit të Tenderit dhe do t'u komunikohet me shkrim të gjithë atyre që kanë marrë Dokumentin e Tenderit dhe janë regjistruar. Për t'u dhënë Ofertuesve të mundshëm kohë të arsyeshme për të marrë parasysh një shtesë në përgatitjen e ofertave të tyre, Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, sipas gjykimit të tij, mund të zgjasë afatin për dorëzimin e ofertave.

## 3. Përgatitja e Ofertës

**3.1. Gjuha:** Siç përcaktohet nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit, gjuha e ofertës është gjuha shqipe dhe çdo dokument, kontrata, certifikata, referenca të marra nga palë të treta në gjuhë të ndryshme nga ajo shqipe, duhet të përkthehen. Noterizimi nuk është i domosdoshëm, por kopjet e noterizuara do t'i kërkojnë fituesit nga Fondacioni për lidhjen e kontratës.

**3.2. Kostoja e Ofertës:** Ofertuesi do të përballojë të gjitha kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

e ofertës së tij dhe Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit në asnjë rast nuk do të jetë përgjegjës për ato kosto, pavarësisht nga zhvillimi ose rezultati i procesit të prokurimit.

### 3.3. Paraqitja e Ofertës: Oferta do të përmbajë zarfet e mëposhtëm:

- Një zarf “Origjinal” të Ofertës Teknike, të vulosur, i cili do të përmbajë vetëm informacion teknik dhe do të shënohet “Origjinal - Oferta Teknike”.
- Një zarf “Origjinal” të Ofertës Financiare, të vulosur, i cili do të përmbajë vetëm informacion financiar dhe do të shënohet “Origjinal - Oferta Financiare”.
- Një zarf “Kopje” të Ofertës Teknike, të vulosur, i cili do të përmbajë një kopje të dokumenteve teknike dhe do të shënohet “Kopje - Oferta Teknike”.
- Një zarf “Kopje” të Ofertës Financiare, të vulosur, i cili do të përmbajë një kopje të dokumenteve financiare dhe do të shënohet “Kopje - Oferta Financiare”.
- Një zarf “Kopje Elektronike”, i cili do të përmbajë një USB plotësisht funksionale dhe të pastër nga viruset. Skanimi i dokumentacionit të ofertës në USB do të bëhet në dy skedarë, një për Ofertën Teknike dhe një për Ofertën Financiare. Brenda secilit skedar, çdo dokument duhet të skanohet dhe ruhet veçmas, me tituj që tregojnë qartë përmbajtjen.

### 3.4. Dokumentet që përbëjnë Ofertën:

- Oferta Teknike do të përmbajë:

- *Autorizimin për nënshkrimin e Ofertës*, një konfirmim me shkrim i cili autorizon përfaqësuesin e Ofertuesit të nënshkruajë ofertën dhe të mbajë përgjegjësi për të.

- *Dokumentacionin që vërteton pranueshmërinë dhe kualifikimin e Ofertuesit:*

- Licencë e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë në ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale, si person juridik në zbatim, në kategorinë N-Z/A/1 – “Zbatim në konservim dhe restaurim të rrënojave/siteve arkeologjike”, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Në rastin e bashkimit të subjekteve, kjo kërkesë duhet të përmbushet nga të paktën një prej anëtarëve të bashkimit të subjekteve.
- Licencat individuale të ekipit kryesor ose personave të kontraktuar, sipas pozicioneve të përcaktuara në Termat e Referencës. Në rastin e bashkimit të subjekteve, kjo kërkesë duhet të përmbushet nga të paktën një prej anëtarëve të bashkimit të subjekteve.
- Ekstrakt historik nga Regjistri Tregtar, të lëshuar nga QKB, të lëshuar jo më herët se 30 ditë nga data e dorëzimit. Në rastin e bashkimit të subjekteve, kjo kërkesë duhet të përmbushet nga secili prej anëtarëve.
- Të mos jetë në proces falimentimi dhe/ose likuidimi (statusi aktiv). Në rastin e bashkimit të subjekteve, kjo kërkesë duhet të përmbushet nga secili prej anëtarëve.
- Vërtetim se përfaqësuesi ligjor dhe aksionarët/ortakët e shoqërisë nuk janë dënuar për shkelje penale, si dhe nuk janë nën proces hetimi nga ana e organit të prokurorisë, të lëshuar jo më herët se 30 ditë nga data e dorëzimit. Në rastin e bashkimit të subjekteve, kjo kërkesë duhet të përmbushet nga secili prej anëtarëve.
- Vërtetim nga gjykata se subjekti nuk ka proces gjyqësor të hapur në cilësinë e palës së paditur, të lëshuar jo më herët se 30 ditë nga data e dorëzimit. Në rastin e bashkimit të subjekteve, kjo kërkesë duhet të përmbushet nga secili prej anëtarëve.
- Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore të lëshuar nga autoritetet përkatëse tatimore, të lëshuar jo më herët se 30 ditë nga data e dorëzimit. Në rastin e bashkimit të

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

- subjekteve, kjo kërkesë duhet të përmbushet nga secili prej anëtarëve.
8. Vërtetimi i numrit të punonjësve i shoqëruar me listëpagesat për 6 muajt e fundit, që tregojnë mesatarisht të paktën 40 punonjës. Emrat e punonjësve kryesorë të propozuar për punimet pranë Parkut Kombëtar të Butrintit duhet të identifikohen nga Ofertuesi në listëpagesën e tre muajve të fundit. Në rastin e bashkimit të subjekteve, kjo kërkesë duhet të përmbushet bashkarisht nga të gjithë anëtarët.
  9. Vërtetimin e xhiros vjetore të realizuar gjatë viteve 2023, 2024, 2025, të lëshuar nga organet tatimore përgjegjëse. Xhiro mesatare vjetore duhet të jetë jo më pak se 23,121,000 Lekë. Në rastin e bashkimit të subjekteve, kjo kërkesë duhet të përmbushet bashkarisht nga të gjithë anëtarët.
  10. Një vërtetim të gjendjes financiare nga një ose më shumë banka, lëshuar jo më herët se 30 ditë nga data e dorëzimit. Gjendja financiare duhet të jetë jo më pak se 5,781,000 Lekë. Në rastin e bashkimit të subjekteve, kjo kërkesë duhet të përmbushet bashkarisht nga të gjithë anëtarët.
  11. Deklaratë mbi mospërfshirjen në ndonjë listë me sanksione të lëshuar nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara, Kombet e Bashkuara ose Bashkimi Evropian, ose Agjencia e Prokurimit Publik.
  12. Deklaratë se nuk janë fajtorë për shkelje të rënda profesionale, përfshirë keqinterpretime serioze në dhënien e informacionit, mashtrim dhe korrupsion dhe shkelje të detyrimeve kontraktuale.
  13. Deklarimi i konfliktit të interesit me çdo drejtor apo menaxher të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit, nëse ka. Mungesa e një deklarimi të tillë, nëse ekziston konflikti, do të çojë në përjashtimin nga prokurimi aktual dhe përjashtimin e mundshëm nga procedurat e ardhshme të prokurimit.

Kriteret e përcaktuara në pikat 3 - 13 duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklarimit të Ofertuesit, në ditën e hapjes së ofertave, sipas Formularit nr. 2. Formular vetëdeklarimi, Formularit nr. 3 për kapacitetin ekonomik dhe financiar. Dokumentacioni vërtetues kërkohet për pikat 3 - 10 më lart dhe do të dorëzohet nga Ofertuesi i renditur i pari në klasifikimin e Ofertuesve.

*- Dokumentacionin që vërteton përputhshmërinë me kërkesat teknike:*

1. CV të shoqërisë për aktivitetin e saj për 5 vitet e fundit, ku të përfshihen kontaktet e përfaqësuesve të institucioneve kontraktuese për referencë (person kontakti, nr. telefoni dhe adresë email). Në rastin e bashkimit të subjekteve, kjo kërkesë duhet të përmbushet nga secili prej anëtarëve.
2. Organizimi dhe Metodologjia e punimeve sipas Formularit nr. 6.
3. Minimumi dy kopje kontratash për punime të ngjashme të realizuara në zona të trashëgimisë kulturore ose parqet kombëtare, në një vlerë jo më pak se 23,120,000 Lekë, të përfunduara në pesë vitet e fundit, të shoqëruara me procesverbal kolaudimi ose referenca ose formularë vlerësimi të punëve nga institucionet kontraktuese. Numri maksimal i kontratave të pranuar do të jetë 5. Në rastin e bashkimit të subjekteve, kjo kërkesë duhet të përmbushet bashkarisht nga të gjithë anëtarët. Plotësoni saktë Formularin nr. 5 për eksperiencat e ngjashme.
4. Lista e emrave të ekipit kryesor të planifikuar për të punuar në këtë projekt të shoqëruar me CV-të, diplomat dhe licencat e tyre (aty ku është e aplikueshme), sipas Formularit nr. 6 për ekipin kryesor.

Ekipi Kryesor do të përbëhet nga të paktën këto pozicione individuale:

- Drejtues teknik restaurimi, i pajisur me licencën përkatëse Z/A/1;
- Inxhinier ndërtimi i licencuar;
- Arkitekt i licencuar;
- Specialist i certifikuar për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë HSE
- Arkeolog i licencuar sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore, kategoritë A1, A2, A3.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

- o Teknik i mesëm ndërtimi për logjistikën e kantierëve.

Ofertuesi duhet të propozojë vetëm një ekspert për secilin pozicion, duke mos mbuluar disa pozicione nga i njefti individ. Mosplotësimi i kësaj kërkesë mund të rezultojë në refuzimin e ofertës.

- Sigurimin e ofertës, në vlerën **1,157,000 Lekë**.

b. Oferta Financiare do të përmbajë:

*Formularin e Ofertës* , sipas Formularit nr. 1. Formulari i Ofertës (origjinal) .

*Preventivin / buxhetin e detajuar*, sipas Formularit nr. 8. Preventivi (origjinal).

Këta formularë do të plotësohen nga Ofertuesi në hapësirat boshe, pa ndryshuar përmbajtjen e tyre. Mosplotësimi ose ndryshimi i këtyre formularëve përbën shkak për skualifikim.

**Fituesit do t'i kërkohej të dorëzojë kopjet origjinale ose të noterizuara të të gjithë dokumenteve të Ofertës së tij. Çdo ndryshim i dokumenteve do të jetë shkak për dënime të ashpra, deri në përjashtim të përhershëm nga prokurimi në Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit.**

**3.5. Rasti i bashkimit të subjekteve:** Përvec dokumentave të kërkuara në pikën 3.4, oferta e paraqitur nga një bashkim subjektësh duhet të përmbajë marrëveshjen e bashkëpunimit ose një letër të nënshkruar nga subjektet që synojnë krijimin e një bashkimi subjektësh në rastin e shpalljes fitues, si dhe prokurën që cakton një përfaqësues që do të veprojë për dhe në emër të bashkimit të subjekteve gjatë gjithë procesit të prokurimit dhe zbatimit të kontratës, si dhe për kryerjen e pagesave, në rast të shpalljes fitues. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e punimeve që do të kryejë secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

### **3.6. Çmimet e Ofertave:**

Çmimi i kuotuar në Formularin e Ofertës do të jetë çmimi total i Ofertës. Ky çmim duhet të përfshijë të gjitha pagesat e detyrueshme, taksat dhe detyrimet. TVSH-ja do të llogaritet dhe tregohet veçmas në mënyrën e treguar në formularët përkatës.

Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit synon të pranojë ofertat për kontratë me çmim për njësi (*Kontratat me çmim për njësi janë marrëveshje ku janë fikse vetëm çmimet e artikujve, ndërsa vëllimet apo njësitë mund të ndryshojnë, në varësi të nevojave aktuale të projektit*).

Çmimet për njësi të kontratës do të jenë fikse gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Ofertuesi do të plotësojë çmimet për të gjithë zërat e preventivit. Preventivi duhet të përfshijë të gjithë informacionin e kërkuar dhe duhet të përmbajë një analizë të detajuar të çmimeve. Zërat për të cilët nuk janë vendosur çmime nuk do të paguheshin gjatë zbatimit të kontratës, por do të konsiderohen të mbuluar nga zëra të tjerë.

Monedha e Ofertës është Lekë.

**3.7. Vlefshmëria e Ofertës:** Çdo ofertë do të jetë i vlefshëm për të paktën 150 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të saj.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

**3.8. Sigurimi i Ofertës:** Ofertuesi do të dorëzojë si pjesë të Ofertës Teknike një sigurim oferte të lëshuar nga banka ose institucione financiare me reputacion të mirë, sipas formularit nr. 7. Formulari i Sigurimit të Ofertës. Në rastin e bashkimit të subjekteve, sigurimi i ofertës do të jetë në emër të bashkimit të subjekteve ose në emër të bashkimit të ardhshëm të subjekteve, sipas letrës së qëllimit, që dorëzon ofertën. Ofertat që nuk shoqërohen me sigurimin e ofertës do të refuzohen. Sigurimi i ofertës vetëm në emër të njërit prej anëtarëve rezulton në refuzim të menjëhershëm të ofertës.

Sigurimi i ofertës i kthehet Ofertuesit të suksesshëm menjëherë pas dorëzimit të Sigurimit të Kontatës.

Sigurimi i ofertës i kthehet Ofertuesve të tjerë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës me Ofertuesin e suksesshëm.

Sigurimi i ofertës u kthehet të gjithë Ofertuesve në rast se procedura anulohet.

Sigurimi i ofertës mund të konfiskohet në rast se: (i) Ofertuesit tërheqin ofertën brenda periudhës së vlefshmërisë së ofertave dhe (ii) Ofertuesi fitues nuk dorëzon sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën.

**3.9. Nënshkrimi i Ofertës:** Oferta do të nënshkruhet nga personi i autorizuar nga Ofertuesi nëpërmjet një autorizimi me shkrim. Në rastin e bashkimit të subjekteve, oferta nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar nga bashkimi i subjekteve, në emër të bashkimit të subjekteve, dhe është detyrues për të gjithë anëtarët e bashkimit të subjekteve.

#### 4. Dorëzimi i Ofertës:

**4.1. Paketimi final i dokumentacionit:** Pasi të jenë përgatitur dhe etiketuar të gjitha zarfet sipas udhëzimeve në pikën 3.3, ato duhet të vendosen së bashku në një paketë të vetme të mbyllur dhe të vulosur. Në pjesën e jashtme të paketës duhet të shënohet qartë:

Emri dhe adresa e Ofertuesit

Drejtuar: Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit; Adresa: Rruga "SH81", Parku Kombëtar i Butrintit, Ksamil, Shqipëri.

Objekti dhe numri i referencës së prokurimit

Paralajmërimi: “TË MOS HAPET PARA DATËS DHE ORËS SË CAKTUAR PËR HAPJEN E OFERTAVE”

**4.2. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (me zarf të mbyllur) është data 20 Korrik 2026, ora 11:00.**

4.3. Oferta mund të paraqitet personalisht ose me postë në zyrën e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit në Sarandë (adresa e dhënë më sipër).

Për dorëzimin e ofertave që bëhet përmes postës do të merret në konsideratë data dhe ora e dorëzimit sipas vulës së postës, e cila duhet të jetë brenda afatit të fundit për dorëzimin e ofertave. Ofertat e dorëzuara pas këtij afati, do të refuzohen dhe do të kthehen nga Fondacioni të pahapura. Në rast të dorëzimit me postë, Ofertuesi duhet të njoftojë Fondacionin për këtë, përndryshe Fondacioni nuk ka

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

detyrim të presë ofertën deri në hapjen e ofertave.

4.4. Fondacioni mund të shtyjë afatin e dorëzimit të ofertave, sipas gjykimit të tij, nëpërmjet një amendimi të Kërkesës për Tender.

**4.5. Tërheqja, zëvendësimi dhe modifikimi i ofertave:** Një Ofertues mund të tërheqë, zëvendësojë ose modifikojë Ofertën e tij pasi të jetë dorëzuar duke dërguar një njoftim me shkrim, të nënshkruar siç duhet nga një përfaqësues i autorizuar. Të gjitha njoftimet duhet të merren nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit përpara afatit të përcaktuar për dorëzimin e ofertave. Ofertat e tërhequra do t'u kthehen të pahapura Ofertuesve. Asnjë ofertë nuk mund të tërhiqet, zëvendësohet ose modifikohet në intervalin ndërmjet afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe skadimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertave të specifikuar nga Ofertuesi në formularin e ofertës ose në ndonjë zgjatje të tyre.

## 5. Hapja dhe vlerësimi i ofertave

**5.1. Hapja e ofertave:** Në rastet kur priten oferta me postë, Fondacioni do të hapë ofertat ose në momentin që të gjithë ofertat e pritura kane arritur ose 7 ditë kalendarike pas afatit të fundit për dorëzimin e ofertave, në orën e parashikuar, cilado nga këto ngjarje të realizohet e para. Ofertat do të hapen nga përfaqësuesit e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit.

**5.2. Vlerësimi i Ofertave:** Komiteti i Vlerësimit të Tenderit (KVT) do të kontrollojë ofertat për t'u siguruar që ato nuk përmbajnë ndryshime në terma ose gabime. Për të ndihmuar në ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, KVT, sipas gjykimit të tij, mund të kërkojë ndihmë nga profesionistë të tjerë në cilësinë e konsulentit të KVT. Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit rezervon të drejtën të pranojë ose refuzojë çdo, të gjitha, ose një pjesë të ofertave të paraqitura pa dhënë arsye për vendim të tillë.

Gjatë vlerësimit të ofertave, KVT mund të kërkojë nga Ofertuesit sqarime me shkrim për ofertat e tyre brenda një afati të arsyeshëm. Oferta mund të refuzohet nëse Ofertuesi nuk jep sqarime brenda afatit të caktuar. Sqarimet nuk mund të ndryshojnë cmimet apo përmbajtjen e ofertës në asnjë rrethanë, përveç gabimeve aritmetike të gjetura nga KVT. Gjithashtu, KVT ka të drejtën të verifikojë informacionin e paraqitur nga Ofertuesit në rast se një gjë e tillë është e nevojshme.

**5.3. Ekzaminimi paraprak i Ofertave:** KVT do të verifikojë nëse ofertat janë firmosur sic duhet dhe nëse janë dorëzuar të gjithë formularët e kërkuar. Ofertat që plotësojnë kriteret e Kërkesës për Tender pa devijime të rëndësishme kalojnë për vlerësim të mëtejshëm.

**5.4. Vlerësimi i kriterëve të pranueshmërisë dhe kualifikimit:** KVT do të verifikojë nëse ofertat plotësojnë kriteret e pranueshmërisë dhe kualifikimit. Paraqitja e të gjithë dokumenteve në formën, përmbajtjen dhe afatin e kërkuar bën të mundur kualifikimin e Ofertuesit.

**5.5. Vlerësimi Teknik:** Ofertat do të vlerësohen fillimisht për cilësitë teknike, duke vlerësuar kapacitetin e kompanisë përmes dokumentacionit të dorëzuar. Mangësitë mund të ndikojnë në rezultatet dhe mundësinë për të fituar. Pragjet e cilësisë janë vendosur si në tabelë:

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

Kriteret	Dokumentacioni	Shpërndarja e pikëve
Kualifikimet dhe përvoja e ekipit kryesor	Lista e stafit kryesor të propozuar.	30 %
Kualifikimi dhe eksperiencia e kompanisë zbatuese	Kontrata për punime të ngjashme të kryera në site kulturore apo parqe, organizimi dhe metodologjia	30%
Oferta Financiare	Oferta Financiare e Detajuar për Punimet.	40 %
<b>TOTAL:</b>		<b>100%</b>

Ofertat që shënojnë më pak se **60%** për të paktën një kriter cilësor dhe më pak se **70%** për kriteret cilësore në përgjithësi, do të përjashtohen nga pjesa tjetër e procedurës së vlerësimit.

#### 5.6. Korrigjimi i gabimeve aritmetike. Gabimet aritmetike korrigjohen si më poshtë:

- në rast se ka mospërputhje ndërmjet shumave të shprehura në shifra dhe atyre në fjalë, mbizotërojnë shumtë e shprehura në fjalë, me përjashtim të rasteve kur shumtë në fjalë lidhet me një gabim aritmetik;
- në rast se ka mospërputhje ndërmjet cmimit njësi dhe vlerës që rezultojnë nga shumëzimi i cmimit njësi me sasinë, mbizotëron cmimi njësi;
- nëse ka një gabim në një shumtë totale që rezultojnë nga mbledhja ose zbritja e nëntotaleve, mbizotëron nëntotali dhe korrigjohet shumtë totale.

Shumtë e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për Ofertuesin. Mospranimi i gabimeve aritmetike rezultojnë në refuzimin e ofertës, pa konfiskim të sigurimit të ofertës.

**5.7. Vlerësimi financiar** pason vlerësimin teknik dhe bazohet në kosto. Kriteri i koston vlerësohet duke i dhënë numrin maksimal të pikëve në dispozicion për kriterin e koston ofertës më të ulët të kualifikuar. Pjesa tjetër e ofertave vlerësohet duke përdorur një formulë që lejon vlerësimin proporcional të pikëve.

**5.8. Ofertat anomalisht të ulëta:** Ofertat do të shqyrtohen nga afër për të përcaktuar anomalitë e çmimeve. Ofertat që vlerësohen nga Komiteti i Vlerësimit të Tenderit si anomalisht të ulëta do të skualifikohen mbi këtë bazë, pavarësisht nga pikët e tyre teknike. Ky vendim kërkon verifikim, i cili përfshin edhe Ofertuesin.

#### 5.9. Tejkalimi i fondit limit:

**Ofertat me një çmim më të lartë se fondi limit i treguar në pikën 1.3 do të përjashtohen nga pjesa tjetër e procedurës së vlerësimit.**

#### 5.10. Përzgjedhja e fituesit:

Përzgjedhja e Ofertuesit të suksesshëm do të bazohet në renditjen e ofertave të kualifikuara sipas pikëve kumulative të fituara nga vlerësimi i kriterëve teknike dhe financiare.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

**6. Dhënia e kontratës:** Brenda periudhës së vlefshmërisë së ofertave, Fondacioni do të njoftojë me shkrim Ofertuesin e suksesshëm për pranimin e ofertës, nëpërmjet Formularit nr. 9. Letra e Pranimit, ku do të kërkohet edhe pranimi i gabimeve aritmetike, nëse ka.

**Ofertuesit të suksesshëm do t'i kërkohet të dorëzojë kopjet e noterizuara të të gjithë dokumenteve të Ofertës. Cdo ndryshim i dokumenteve do të jetë shkak për dënime të ashpra, deri në përjashtim të përhershëm nga tenderimi në Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit. Në rastin e shpalljes fitues të një bashkimi subjektësh, do të kërkohet dorëzimi i kopjes së noterizuar të marrëveshjes së bashkimit të subjekteve para nënshkrimit të kontratës.**

**7. Sigurimi i kontratës:** Brenda 10 ditëve të punës nga data e Njoftimit për pranimin e ofertës nga Fondacioni, Ofertuesi i suksesshëm do të dorëzojë sigurimin e kontratës në formën e garancisë bankare, në vlerën 10% të vlerës së Ofertës dhe në përputhje me Formularin nr. 10. Formulari i Sigurimit të Kontratës. Në rast se Ofertuesi i suksesshëm dështon të dorëzojë sigurimin e kontratës, kjo përbën shkak për anulimin e dhënies së kontratës dhe konfiskimin e sigurimit të ofertës. Në rastin e bashkimit të subjekteve, Sigurimi i Kontratës do të jetë në emër të bashkimit të subjekteve.

**8. Nënshkrimi i kontratës:** Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dyja palët.

**9. Ankesat:** Ofertuesit jo të suksesshëm kanë të drejtë të paraqesin me shkrim kërkesë për sqarim ose ankesë në lidhje me procesin e prokurimit brenda 5 ditëve të punës nga data e marrjes dijeni të rezultateve përfundimtare të vlerësimit, në adresën e emailit tenders@bmf.al. Fondacioni do të kthejë përgjigje me shkrim brenda 5 ditëve të punës nga marrja e kërkesës për sqarim ose ankesës.

**10. Anullimi i procesit të prokurimit:** Fondacioni i Menaxhimit të Butrintit rezervon të drejtën të pranojë ose refuzojë cdo ofertë, të anulojë procesin e prokurimit dhe të refuzojë të gjitha ofertat në cdo kohë para dhënies së kontratës, pa patur ndonjë përgjegjësi ndaj Ofertuesve.

**11. Informacion shtesë:**

- 1- Të gjitha dokumentet e ofertës duhet të plotësohen plotësisht për të shmangur skualifikimin.
- 2- Nënkontraktimi nuk lejohet.
- 3- Ofertuesit jo të suksesshëm do të njoftohen mbi rezultatin e procesit të përzgjedhjes menjëherë pas nënshkrimit të kontratës me Ofertuesin e suksesshëm.

**11. Periudha e Performancës:** Punimet për këtë kontratë parashikohet të përfundojnë sipas grafikut të punimeve nga data e nënshkrimit të kontratës.

**13. Standardet e Performancës:** Punimet duhet të ndërmerren brenda të gjitha rregullave, rregulloreve dhe ligjeve përkatëse në fuqi aktualisht në Shqipëri dhe nga praktikat më të mira të industrisë.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

### Formulari nr. 1. FORMULARI I OFERTËS

Data:  
Titulli dhe numri i referencës së prokurimit:  
Për: Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit  
Ofertuesi:

Unë, i nënshkruari

(Emri dhe numri i identitetit të përfaqësuesit ligjor)

Përfaqësues i

(Emri dhe adresa e kompanisë)<sup>1</sup>

Deklaroj se kushtet e mëposhtme janë të zbatueshme për ne:

- (a) Ne kemi shqyrtuar dhe pranojmë pa asnjë rezervë kushtet e Kërkesës për Tender.
- (b) Ne pranojmë të kryejmë punimet e kërkuara në përputhje me kërkesat teknike të Kërkesës për Tender.
- (c) **Cmimi i Ofertës sonë është:**

**Lekë ( Pa TVSH)**

*(Me shifra dhe fjalë)*

- (d) Oferta jonë është e vlefshme për 150 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të saj dhe do të mbetet e detyrueshme për ne dhe mund të pranohet në çdo kohë përpara skadimit të asaj periudhe.
- (e) Ne deklarojmë se plotësojmë kërkesat e pranueshmërisë dhe kualifikimit sic specifikohet në Kërkesën për Tender. Ne marrim përsipër, në rast se do të kërkohet, të dorëzojmë dokumentacionin vërtetues të këtyre kërkesave.
- (f) Në rast se Oferta jonë pranohet, do të dorëzojmë Sigurimin e Kontratës, sipas kushteve të përcaktuar në Kërkesën për Tender.
- (g) Ne e kuptojmë që kjo Ofertë, bashkë me Letrën tuaj të Pranimit, do të jetë një kontratë detyruese për ne, deri në përgatitjen dhe finalizimin e kontratës formale.
- (h) Ne e kuptojmë që ju nuk jeni të detyruar të pranoni Ofertën më të ulët, Ofertën më të favorshme, apo cdo Ofertë që ju është dorëzuar.

Emri \_\_\_\_\_ Nënshkrimi, vula \_\_\_\_\_

<sup>1</sup> Në rastin e bashkimit të subjekteve, vendos emrat e anëtarëve të bashkimit të subjekteve dhe bashkëlidh autorizimin për përfaqësimin e bashkimit të subjekteve.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

## Formulari nr. 2. FORMULAR VETË - DEKLARIMI

### A. DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PRANUESHMËRISË DHE KUALIFIKIMIT

<b>Deklarata</b>
<p>Ne jemi një kompani e regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Ne nuk jemi të falimentuar apo në proces falimentimi dhe/ose likuidimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Ne nuk jemi dënuar për një vepër penale dhe nuk jemi nën proces hetimi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Përfaqësuesi ligjor dhe aksionarët ose ortakët e shoqërisë nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe nuk janë nën proces hetimi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Ne nuk kemi proces gjyqësor të hapur në cilësinë e palës së paditur.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Ne kemi përmbushur detyrimet lidhur me pagesën e sigurimeve shoqërore dhe taksave sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Ne nuk jemi dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale, përfshirë keqinterpretime serioze në dhënen e informacionit dhe shkelje të detyrimeve kontraktuale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Ne nuk po dorëzojmë Oferta tjetër si Ofertues i vetëm apo anëtar i një bashkimi subjektsh.</p>

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme \_\_\_\_\_

Ne nuk jemi dhe kemi marrë masa të mos gjendemi në situata mashtrimi dhe korrupsioni.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme \_\_\_\_\_

Ne nuk jemi në asnjë prej situatave të konfliktit të interesit të përcaktuara në këtë Kërkesë për Tender.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme \_\_\_\_\_

Ne nuk jemi përfshirë në ndonjë listë me sanksione të lëshuar nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara, Kombet e Bashkuara ose Bashkimi Evropian, ose Agjencia e Prokurimit Publik.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme \_\_\_\_\_

## B. DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE GRAFIKUT TË REALIZIMIT TË PUNIMEVE

### Deklarata

Ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Fondacioni i Menaxhimit të Butrintit.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme \_\_\_\_\_

Emri \_\_\_\_\_ Nënshkrimi \_\_\_\_\_ Data \_\_\_\_\_

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

## 2. Deklarimi i Konfliktit të Interesit

Ofertuesi:

Unë, i nënshkruari

---

(Emri dhe numri i identitetit të përfaqësuesit ligjor)

Përfaqësues i

---

(Emri dhe adresa e kompanisë)

Deklaroj se:

- Unë ose kompania që përfaqësoj, **nuk** kemi asnjë marrëveshje kompensimi ose interes tjetër ose lidhje me ndonjë drejtor ose menaxher të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit.
- Unë ose kompania që unë përfaqësoj, **nuk** kemi asnjë rrethanë tjetër që, në fakt ose në dukje, mund ta vështirësojë ushtrimin e pavarësisë, gjykimin objektiv ose në ndonjë mënyrë tjetër kryerjen me efektivitet të detyrave të mia si kontraktues, nëse zgjidhet.

Nëse ndonjë nga deklaratat më sipër nuk është e vërtetë ose kërkon shpjegim, ju lutemi përshkruani faktet përkatëse:


Emri \_\_\_\_\_ Nënshkrimi \_\_\_\_\_ Data \_\_\_\_\_

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

Formulari nr. 3. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

Ofertuesi:

A. Formulari i Xhiros Vjetore

A.1. Plotësoni në rastin e Ofertuesit të vetëm

Viti	Shuma në Lekë
2023	
2024	
2025	
Mesatarja	

A.2. Plotësoni në rastin e Bashkimit të Subjekteve

Viti	Bashkimi i subjekteve (ekzistues ose i ardhshëm)		Shuma totale në Lekë
	Anëtari nr. 1 (lideri)	Anëtari nr. 2	
2023			
2024			
2025			
Mesatarja			

B. Formulari i Burimeve Financiare

B.1. Plotësoni në rastin e Ofertuesit të vetëm

Nr.	Burimi i Financimit	Shuma në Lekë
1		
2		
3		
...		

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

## B.2. Plotësoni në rastin e Bashkimit të Subjekteve

Burimi i financimit	Bashkimi i subjekteve (ekzistues ose i ardhshëm)		Shuma totale në Lekë
	Anëtari nr. 1 (lideri)	Anëtari nr. 2	
1			
2			
3			
.....			

## C. Dokumentacioni vërtetues për gjendjen ekonomike dhe financiare

- Vërtetim nga organet tatimore mbi xhiron vjetore të realizuar nga Ofertuesi gjatë viteve 2023, 2024, 2025. Në rastin e Bashkimit të subjekteve, kjo kërkesë duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve.
- Vërtetime nga një ose më shumë banka mbi gjendjen financiare të Ofertuesit. Në rastin e Bashkimit të subjekteve, kjo kërkesë duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve.

Emri \_\_\_\_\_ Nënshkrimi \_\_\_\_\_ Data \_\_\_\_\_

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

**Formulari nr. 4. Ekipi kryesor i propozuar për këtë projekt**

Ofertuesi:

Ju lutemi plotësoni formularin dhe bashkëngjitni CV-të, Diplomat dhe kontratat e përvojës së mëparshme ose referencat për Menaxherët dhe Specialistët kryesorë që do të punojnë në këtë projekt

Nr	Emër Mbiemër	Data e lindjes	Arsimi	Detyra e caktuar	Licencat	Vite përvojë në detyrën e caktuar
1						
2						
3						

Emri \_\_\_\_\_ Nënshkrimi \_\_\_\_\_ Data \_\_\_\_\_

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

*Formulari nr. 5. Eksperienca e ngjashme*

**A. Eksperiençë e ngjashme**

<b>Ofertuesi:</b>
-------------------

**PLOTËSONI NJË (1) FORMULAR PËR ÇDO KONTRATË DHE BASHKËLIDHNI KONTRATËN OSE REFERENCËN NGA INSTITUCIONI KONTRAKTUES**

<b>Kontratë me madhësi dhe natyrë të ngjashme</b>			
Identifikimi dhe përshkrimi i kontratës			
Kontratë e paraqitur në përgjigje të kërkesave për kualifikim <input type="checkbox"/>	Kontratë e paraqitur për pikë shtesë <input type="checkbox"/>		
Data e fillimit		Data e përfundimit	
Roli në kontratë	Kontraktor kryesor		Nënkontraktor
Shuma totale e kontratës			
<b>Shuma totale e komponentit të shërbimit</b> (e rëndësishme nëse kontrata përmban elementë të ndryshëm nga shërbimet e tenderit, blerja e pajisjeve, mobiljeve etj.)			
Nëse është partneritet në një sipërmarrje të përbashkët ose nënkontraktor, specifikoni pjesëmarrjen në shumën totale të kontratës	Përqindja e totalit	Shuma	
Kontraktuar nga: Adresë Emri i kontaktit Numri i telefonit/celularit: E-mail:			
<b>Përshkrimi i ngjashmërisë</b>			

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

### B. Punët në proces/Kontrata të zotuarra

**Ofertuesi:**

Ofertuesit duhet të japin informacion në lidhje me **angazhimet e tyre aktuale** për të gjitha kontratat që i janë dhënë, ose për të cilat është marrë një letër angazhimi ose pranimi, ose për kontratat që i afrohen përfundimit, por për të cilat ende nuk është lëshuar një certifikatë përfundimi të plotë.

Nr.	Emri dhe numri i projektit	Vlera e Kontratës	Adresa e Kontaktit të investitorit, Tel	Vlera e punës së papërfunduar Lekë	Data e parashikuar e përfundimit	Data e përfundimit në kontratë
1						
2						
3						
4						
5						

Emri \_\_\_\_\_ Nënshkrimi \_\_\_\_\_ Data \_\_\_\_\_

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

Formulari nr. 6

## ORGANIZIMI DHE METODOLOGJIA E PUNIMEVE

*[Për tu plotësuar nga Ofertuesi]*

Paraqitni këtu një përshkrim të organizimit të punimeve, i cili duhet të përfshijë:

- Metodologjinë e realizimit të punimeve restauruese;
- Organizimin e kantierit;
- Planin e menaxhimit të sigurisë në punë;
- Masat për mbrojtjen e monumentit dhe të mjedisit përreth gjatë zbatimit të punimeve;
- Planin e sigurimit të cilësisë së materialeve.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

Formulari 7

[Letër me kokën e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit

Adresa: Rruga "SH81", Parku Kombëtar i Butrintit, Ksamil

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga ofertuesi i lartpërmendur.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e vlefshmërisë së ofertave.

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

### **Formulari nr. 8. PREVENTIVI DHE ANALIZA E ÇMIMEVE**

Ju lutemi bashkëngjitni preventivin dhe analizën e çmimeve.

#### **\*Preventivi**

Preventivi do të plotësohet sipas preventivit memec bashkëlidhur këtij dokumenti.

- *Preventivi i mëposhtëm përfaqëson kategoritë e kostove.*
- *Çdo zë i këtij preventivi duhet të mbështetet në Klasifikimet Ligjore të Kostove dhe Analizat Teknike të Çmimeve nga Manualet Teknike përkatëse, në përputhje me VKM në fuqi (V.K.M nr. 616, datë 13.04.2023) dhe Vendimin e KKTKM për miratimin e Manualit të Restaurimit. Për zërat që nuk përfshihen në këto Manuale, të bëhet analiza e çmimit.*
- *Përgatitja e preventivit të detajuar sipas specifikimeve të projektit me programin e punimeve të ndarë sipas kategorive dhe zërave të punës.*
- *Preventivi i punimeve përfshin fond rezervë për punime të paparashikuara në masën 20% të vlerës së punimeve, në përputhje me VKM nr.1125, datë 30.12.2020 “Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre”.*

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

### *Formulari nr. 9. LETRA E PRANIMIT*

*[Data]*

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e Ofertuesit fitues]*

Procedura e prokurimit:

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ju informojmë se oferta juaj e paraqitur më datë [\_\_\_\_\_], me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, e korigjuar *[vendos vetëm në rast se ka gabime aritmetike]* është pranuar nga Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit.

Për sa më lart, ju kërkujmë që:

1. Të konfirmoni nëse pranoni korigjimin e gabimeve aritmetike *[fshi në rast se nuk ka gabime aritmetike]*.
2. Të dorëzoni Sigurimin e Kontratës sipas udhëzimeve të përcaktuara në paragrafin 7 të Kërkesës për Tender.

Për: Fondacionin për Menaxhimin e Butrintit

Emri dhe nënshkrimi:

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

## Formulari nr. 10

[ Për t'u paraqitur nga Ofertuesi i suksesshem]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

[Data]

Për: Fondacioni për Menaxhimin e Butrintit

Adresa: Rruga "SH81", Parku Kombëtar i Butrintit, Ksamil

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ objekti]

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [emri i ofertuesit të përcaktuar fitues] t'i jetë akorduar kontrata,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të përcaktuar fitues] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] në një shumë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me [emri i autoritetit kontraktor]

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos-përbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës]

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

*Formulari nr. 11. DRAFT KONTRATA*  
(Për tu finalizuar me Ofertuesin e suksesshëm)

**KONTRATË SHËRBIMI**

*“Titulli”*

Sot më datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026, lidhet kjo kontratë shërbimi (“Kontrata”) midis palëve të mëposhtme:

**Fondacioni Për Menaxhimin e Butrintit**, një organizatë jofitimprurëse e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar pranë Regjistrimit të Organizatave Jofitimprurëse me Vendim Gjykatë nr. 858, datë 22.07.2021, me NUIS: M12108451N, me seli në adresën “Parku Kombëtar i Butrintit, Rr. SH81, Kodi postar 9701”, përfaqësuar nga Znj. \_\_\_\_\_ (në vijim “**BMF**”),

*dhe*

[Emri i Kontraktorit], një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me adresë [vendos adresen], regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS: [vendos numrin], përfaqësuar nga [emri i perfaqësuesit] (në vijim “**Ofruesi i Shërbimit**”).

*Në vijim, veçmas referuar si “Pala” dhe së bashku “Palët”.*

**MEQENËSE:**

- A.** BMF është themeluar nga Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë dhe Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (**AADF**) si një organizatë jofitimprurëse pa anëtarësim në formën e “fondacionit”.
- B.** BMF vepron në fushën e trashëgimisë kulturore, dhe në mënyrë specifike, qëllimi i saj është administrimi indirekt i nënzoneve të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, të Parkut Kombëtar të Butrintit, një pasuri me vlerë universale (“**Pasuria Kulturore**”), në përputhje me Ligjin Nr. 50/22 “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzoneve të Trashëgimisë Kulturore dhe Peizazhit Kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit” (“**Marrëveshja e Administrimit**”).
- C.** Qëllimet e BMF-së janë të administrojë, ruajë dhe mbrojë asetet e trashëgimisë kulturore të Pasurisë Kulturore. Misioni i BMF është të sigurojë akses publik dhe shërbime, si dhe të promovojë aktivitete studimore dhe kërkimore. Ky mision do të realizohet duke menaxhuar dhe zhvilluar Pasurinë Kulturore në mënyrën më të mirë të mundshme, duke siguruar mjetet financiare të nevojshme dhe personelin e specializuar për ruajtjen dhe zhvillimin e saj gjatë gjithë kohëzgjatjes së administrimit indirekt nga BMF.
- D.** Në zbatim të Planit të Menaxhimit të Integruar 2020-2030, BMF përgatiti Planin dhe Studimin për Menaxhimin e Trafikut, Transportit dhe Vizitorëve dhe Planin e Shëndetit dhe Sigurisë në Parkun Kombëtar të Butrintit. Qëllimi i këtyre planeve ishte të kryenin një vlerësim të kushteve ekzistuese sipas fushës përkatëse që mbulonte secili prej tyre dhe të ofronin rekomandime për të përmirësuar infrastrukturën turistike, orientuese si dhe ulur risqet e rënieve nga lartësitë.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

- E. Prioriteti kryesor i projektit është të sigurojë një orientim të qartë dhe të sigurt brenda parkut, mbrojtjen e monumenteve nga aksesimi i pa autorizuar dhe impakti i ndikimit të turizmit si dhe të minimalizoj riskun e rënies nga lartësitë në të gjithë Qytetin Antik. Këto masa sigurojnë përmirësimin e përvojës së vizitorëve, duke mbrojtur vlerat historike dhe kulturore të parkut.
- F. Në vijim të sa më sipër, BMF shpalli thirrjen për kontraktimin e ekspertëve të fushës me qëllim ofrimin e shërbimit të [vendos titullin].
- G. Për qëllim të sa më sipër, Ofruesi i Shërbimit është shpallur fitues i thirrjes, pasi në përfundim të shqyrtimit të ofertave, është vlerësuar si ofertuesi më i përshtatshëm nga pikëpamja teknike dhe financiare.
- H. Duke marrë në konsideratë kushtet dhe rrethanat e mësipërme, Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Kontratë me qëllim formalizimin e marrëdhënies së tyre.

*Në vijim të sa më sipër, Palët bien dakord si më poshtë:*

## **NENI 1 – OBJEKTI I KONTRATËS**

- 1.1. Ofruesi i Shërbimit angazhohet të kryejë të gjitha punimet e nevojshme për [“Titulli i kontrates”] në Parkun Kombëtar të Butrintit, në përputhje me projektin e miratuar nga KKTKM me vendim nr. [nr], datë [vendos datën], dokumentacionin teknik shoqëruar dhe Termat e Referencës, bashkëngjitur kësaj Kontrate si Shtojca 1. Objektivat kryesorë që synohen të arrihen përmes ofrimit të shërbimeve nga Ofruesi i Shërbimit janë:
  - a.
  - b. .
- 1.2. Për realizimin e objektit të parashikuar në paragrafin 1.1 më sipër, Ofruesi i Shërbimit siguron të gjitha burimet njerëzore, pajisjet, mjetet, materialet dhe dokumentacionin teknik të nevojshëm dhe dorëzon punimet dhe dokumentet përkatëse (përfshirë, pa u kufizuar në to, programin e punimeve, preventivat e detajuara, raportet teknike, procesverbalet e kolaudimit, certifikatat e cilësisë dhe garancitë), në përputhje me kushtet, specifikimet teknike dhe afatet e përcaktuara në këtë Kontratë, në projektin e zbatimit, grafikun e punimeve dhe specifikimet teknike që i bashkëlidhen si pjesë integrale.
- 1.3. Çdo shërbim i ofruar mbi bazën e kësaj Kontrate do të jetë në përputhje të plotë me kërkesat dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi për trashëgiminë kulturore, si dhe çdo akt tjetër ligjor apo nënligjor të zbatueshëm.

## **NENI 2 – AFATI I KONTRATËS DHE I DORËZIMEVE**

- 2.1. Kontrata hyn në fuqi menjëherë me nënshkrimin e saj nga Palët. Ofruesi i Shërbimit duhet të fillojë realizimin e shërbimeve menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Kontrate.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

2.2. Kontrata do të mbetet në fuqi deri në përfundimin e afateve të përcaktuara dhe kryerjen e plotë të të gjitha shërbimeve të parashikuara në këtë Kontratë dhe veçanërisht në Shtojcën 1 të saj.

### NENI 3 – SHPËRBLIMI DHE SHPENZIMET

3.1. Pagesa totale për shërbimet sipas kësaj Kontrate është [vendos shumën, në shifra dhe fjale] **ALL pa TVSH.**

3.2. Pagesa e shumës së sipërpërmendur do të kryhet si vijon:

a)

3.3. Pagesat kryhen brenda 30 ditëve nga lëshimi i faturës tatimore dhe konfirmimit nga BMF për dorëzimin e punimeve.

3.4. Tarifa për shërbimet sipas pikës 3.1 përfshin të gjitha shpenzimet e bëra nga Ofruesi i Shërbimit për kryerjen e shërbimeve sipas Shtojcës 1, përfshirë, nëse është e zbatueshme, çdo shpërblim për palë të treta konsulente ose nënkontraktore.

3.5. Përveç kur parashikohet ndryshe nga kjo Kontratë, Ofruesi i Shërbimit nuk do të marrë pagesa të tjera, shpërblime apo rimbursime shpenzimesh në lidhje me shërbimet sipas kësaj Kontrate. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Ofruesi i Shërbimit bie dakord që detyrimi i pagesës së tarifës për shërbimet sipas pikës 3.1 sipas kësaj Kontrate është detyrimi i vetëm i BMF për pagesë ndaj Ofruesit të Shërbimit.

3.6. BMF do të paguajë Ofruesin e Shërbimit përmes transfertës bankare në llogarinë:

**Emri i bankës:** Banka xxxxx

**Emërtimi i llogarisë:** xxxx

**Nr i llogarisë (Lek):**

**Iban:**

### NENI 4 – TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

#### 4.1. Të drejtat dhe detyrimet e Ofruesit të Shërbimit

4.1.1. Ofruesi i Shërbimit angazhohet të kryejë shërbimet e projektimit sipas standardeve më të larta profesionale, duke respektuar afatet dhe duke siguruar materialet dhe personelin e nevojshëm për realizimin e detyrave të përcaktuara në Shtojcën 1.

4.1.2. Ofruesi i Shërbimit ka detyrimin të sigurojë të gjitha pajisjet, softuerët, burimet teknike dhe personelin e specializuar të nevojshëm për kryerjen e shërbimeve sipas kësaj Kontrate.

4.1.3. Ofruesi i Shërbimit do të bashkëpunojë ngushtësisht me BMF gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit, duke informuar periodikisht dhe sa herë t'i kërkohet, mbi progresin e punimeve, problematikat e hasura, rekomandimet për zgjidhje dhe çdo zhvillim të rëndësishëm të projektit.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

- 4.1.4. Ofruesi i Shërbimit, përgjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës, duhet të zotërojë lejet, autorizimet, dhe licencat e nevojshme në përputhje me ligjin e zbatueshëm, me qëllim kryerjen e shërbimeve sipas kësaj Kontrate.
- 4.1.5. Ofruesi i Shërbimit është përgjegjës për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm si dhe për adresimin e çdo kërkesë për sqarim ose ndryshim të projektit që mund të kërkohej nga autoritetet përkatëse, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm në fuqi.
- 4.1.6. Ofruesi i Shërbimit duhet të sigurojë që të gjitha materialet e projektimit dhe dokumentet teknike të përgatiten në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi, standardet ISO, Manualin e Restaurimit dhe aktet nënligjore të përcaktuara në Termat e Referencës dhe Shtojcën 1.
- 4.1.7. Ofruesi i Shërbimit, personeli i tij ndalohen të ndërmarrin çfarëdolloj Praktike të Ndaluar, që përfshijnë si vijon:
1. praktikë shtrënguese, që nënkupton dëmtimin ose kërcënimin për të dëmtuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo palë ose pronë të palës për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në veprimet e një pale;
  2. praktika e marrëveshjes së fshehtë, që nënkupton një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve të krijuara për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një pale tjetër;
  3. praktikë korruptive, që nënkupton ofrimin, dhënien, marrjen ose kërkimin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të çdo gjëje me vlerë për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në veprimet e një pale tjetër;
  4. praktikë mashtruese, që nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqinterpretim, që me vetëdije ose pakujdesi mashtron ose tenton të mashtrtojë një palë për të përfituar një përfitim financiar ose ndonjë përfitim tjetër ose për të shmangur një detyrim; dhe
  5. vjedhje (përvetësim i pasurisë së palës tjetër).
  6. ndalohen pagesat lehtësuese dhe dhuratat që tejkalojnë praktikën e arsyeshme të biznesit; Ofruesi zbaton gjithë legjislacionin antikorrupsion të zbatueshëm.
- 4.1.8. Ofruesit të Shërbimit i ndalohet gjithashtu edhe kryerja e pagesave lehtësuese dhe dhuratat/mikpritja që tejkalojnë praktikën e arsyeshme të biznesit. Në çdo rast, Ofruesi i Shërbimit do të veprojë në përputhje të plotë me të gjithë legjislacionin antikorrupsion të zbatueshëm.
- 4.1.9. Ofruesi i Shërbimit identifikon dhe menaxhon konfliktet e interesit, mban libra dhe evidenca të sakta të pagesave/transaksioneve dhe njofton menjëherë, e në çdo rast jo më vonë se 2 (dy) ditë pune, BMF (dhe, sipas rastit, Ministrinë/Autoritetin Kompetent sipas përkufizimit të dhënë në nenin 6, pika 6.4 të kësaj Kontrate) për çdo dyshim ose informacion në lidhje me përdorimin e një Praktike të Ndaluar. Ofruesi i Shërbimit miraton politika/kontrolle të brendshme dhe trajnon personelin për parandalimin e korrupsionit.
- 4.1.10. Ofruesi i Shërbimit siguron që çdo kontratë e tij me nënkontraktorë për shërbimet sipas kësaj Kontrate (nëse ka) të përmbajë dispozita të ngjashme me paragrafët 4.1.7–4.1.9 (si dhe detyrimet e konfidencialitetit të kësaj Kontrate) dhe bashkëpunon plotësisht me BMF/Ministrinë/Autoritetin Kompetent në çdo verifikim/auditim të arsyeshëm, duke vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës. Çdo shkelje e paragrafëve 4.1.7–4.1.9 përbën shkelje

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

thelbësore të Kontratës dhe i jep BMF-së të drejtën e zgjidhjes sipas nenit 6.

#### 4.2. Të Drejtat dhe Detyrimet e BMF-së:

- 4.2.1. BMF ka të drejtë të monitorojë dhe vlerësojë cilësinë e shërbimeve të ofruara nga Ofruesi i Shërbimit, duke kërkuar në çdo kohë korrigjime apo ndërhyrje shtesë sipas nevojës dhe brenda afateve të arsyeshme.
- 4.2.2. BMF ka detyrimin të vërë në dispozicion informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm që i kërkohet nga Ofruesi i Shërbimit për realizimin e punimeve në mënyrë efektive.
- 4.2.3. BMF-ja do të kryejë pagesat ndaj Ofruesit të Shërbimit sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në Kontratë, pas marrjes dhe verifikimit të dokumentacionit dhe raporteve përkatëse të dorëzuara nga Ofruesi i Shërbimit.
- 4.2.4. BMF-ja ka të drejtë të kërkojë dhe të miratojë paraprakisht çdo ndryshim ose shtyrje afati që mund të ndikojë në realizimin e shërbimeve sipas kushteve të përcaktuara.
- 4.2.5. BMF-ja ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë shpjegime dhe sqarime mbi projektin dhe punimet e dorëzuara nga Ofruesi i Shërbimit, për të siguruar përputhjen me objektivat e projektit dhe cilësinë e rezultateve finale.
- 4.2.6. BMF angazhohet të lehtësojë aksesin në zonë, nëse do të jetë e nevojshme, dhe të ofrojë bashkëpunim të plotë gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës.

#### NENI 5 - KONFIDENCIALITETI

Palët do të ruajnë konfidencialitetin e plotë mbi të gjithë informacionin e shkëmbyer gjatë zbatimit të kësaj Kontrate.

#### NENI 6 – ZGJIDHJA E KONTRATËS

- 6.1. Secila Palë ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e menjëhershme të kësaj Kontrate nëse Pala tjetër nuk përmbush ose shkel detyrimet e përcaktuara në nenin 4 të Kontratës.
- 6.2. Në rast të shkeljes së detyrimeve sipas nenit 4, Pala e prekur duhet t'i dërgojë Palës tjetër një njoftim me shkrim, duke përcaktuar qartë natyrën e shkeljes dhe duke kërkuar korrigjimin e saj brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e marrjes së njoftimit.
- 6.3. Nëse Pala përgjegjëse për shkeljen e detyrimeve nuk merr masa për korrigjimin e shkeljes brenda afatit të parashikuar në pikën 6.2 më sipër, Pala e dëmtuar ka të drejtë të njoftojë me shkrim zgjidhjen e njëanshme dhe të menjëhershme të Kontratës, duke mos mbajtur përgjegjësi për dëmet e mundshme që mund të rezultojnë nga kjo zgjidhje.
- 6.4. BMF, me udhëzim të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (ose çdo autoriteti kompetent “**Autoriteti Kompetent**” apo pasardhësi ligjor si rezultat i riorganizimit të saj, “**Ministria**”) dhe/ose në rast mbarimi ose zgjidhjeje të parakohshme të Marrëveshjes së Administrimit, ka të drejtë të zgjidhë menjëherë këtë Kontratë, pa përgjegjësi dhe pa kosto shtesë për Ministrinë. Njoftimi i BMF-së prodhon efekt në datën e përcaktuar në të.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

- 6.5. Me kërkesë të Ministrisë dhe/ose në rrethanat e pikës 6.4, BMF ka të drejtë të transferojë te Ministria të gjitha të drejtat dhe detyrimet e BMF sipas kësaj Kontrate, pa asnjë kosto shtesë për Ministrinë. Ofruesi i Shërbimit, nëpërmjet nënshkrimit të kësaj Kontrate, bie dakord dhe pranon çdo transferim të tillë, dhe angazhohet të bashkëpunojë plotësisht, përfshirë nënshkrimin e çdo dokumenti të domosdoshëm për bërjen efektiv të transferimit sipas kësaj pike.
- 6.6. Ofruesi i Shërbimit nuk do të ngrejë asnjë pretendim, kërkesë apo padi ndaj Ministrisë apo Autoritetit Kompetent në lidhje me (i) zgjidhjen e kësaj Kontrate sipas pikës 6.4 dhe/ose (ii) transferimin e saj sipas pikës 6.5. Çdo pretendim i Ofruesit të Shërbimit që lidhet me periudhën para transferimit ushtrohet vetëm kundrejt BMF.
- 6.7. Në rast zgjidhjeje të Kontratës sipas këtij neni, ose transferimi të saj sipas pikës 6.5, Ofruesi i Shërbimit do të: (a) dorëzojë te BMF/Ministria/Autoriteti Kompetent menjëherë të gjitha produktet e punës, dokumentacionin teknik, materialet dhe çdo të drejtë përdorimi të lidhur me to; (b) ndërmarrë të gjitha veprimet e arsyeshme për të siguruar transferimin pa pengesa të Shërbimeve; dhe (c) transferojë ose vërë në dispozicion të BMF/Ministrisë/Autoritetit Kompetent çdo kontratë me nënkontraktorë (nëse ka), sipas udhëzimeve të BMF/Ministrisë/Autoritetit Kontraktor.
- 6.8. Asnjë nga veprimet e mësipërme nuk do të krijojë kosto shtesë për Ministrinë/Autoritetin Kompetent, dhe nuk cenon të drejtën e Ofruesit të Shërbimit për të marrë pagesat e pakontestuara për punën e pranuar deri në datën e zgjidhjes, ose transferimit.
- 6.9. Zgjidhja e Kontratës sipas këtij neni nuk e përjashton të drejtën e Palës së dëmtuar për të kërkuar dëmshpërblim në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **NENI 7 – PUBLIKIMET DHE KOMUNIKIMET**

- 7.1. Ofruesi i Shërbimit pranon se nuk do të bëhet asnjë publikim mbi shërbimet dhe rezultatet e punës sipas objektit të kësaj Kontrate, pa miratimin paraprak me shkrim të BMF.
- 7.2. Në rast se pas përfundimit të afatit të kësaj Kontrate, Ofruesi i Shërbimit synon të publikojë të gjithë ose një pjesë të rezultateve të shërbimeve të kryera për BMF ose ta përmendë atë në ndonjë rast publik, Ofruesi i Shërbimit merr përsipër, edhe pas përfundimit të afatit të kësaj Kontrate, t'i dorëzojë BMF, për miratim, projektin jo përfundimtar të publikimit.
- 7.3. Dispozitat e këtij neni do të vazhdojnë edhe pas zgjidhjes së parakohshme ose përfundimit të afatit të Kontratës.

## **NENI 8 – PËRGJEGJËSIA E OFRUESIT TË SHËRBIMIT**

- 8.1. Ofruesi i Shërbimit do të zhdëmtojë dhe do të shkarkojë BMF nga çdo përgjegjësi për dhe kundrejt të gjitha humbjeve dhe dëmeve që janë rezultat i fajit të Ofruesit të Shërbimit në kryerjen e shërbimeve sipas kësaj Kontrate dhe detyrimeve të tij lidhur me to.
- 8.2. Ofruesi i Shërbimit do të jetë përgjegjës për aplikimin dhe mbajtjen në fuqi të të gjitha lejeve, autorizimeve dhe miratimeve të nevojshme që lidhen me kryerjen e shërbimeve sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

## NENI 9 – MBAJTJA E PAGESAVE

9.1. BMF do t'i mbajë nga pagesa Ofruesit të Shërbimit, duke anuluar të gjithë apo një pjesë të pagesës së miratuar, në një masë të tillë sa është e nevojshme për të mbrojtur BMF nga humbjet gjatë kësaj Kontrate të cilat vijnë për shkak të:

- (a) moskryerjes së shërbimeve nga Ofruesi i Shërbimit, me përjashtim të rasteve kur mospërmbushja vjen për shkak që nuk varen nga ai;
- (b) mospërmbushjes nga Ofruesi i Shërbimit dhe/ose rezultatit të pakënaqshëm të shërbimeve, kur BMF i ka tërhequr më parë vëmendjen.

9.2. Ndalimi në pagesa nga BMF ndaj çdo pagese të ndërmjetme nuk do të ndikojë në detyrimin e Ofruesit të Shërbimit për të vazhduar përmbushjen e shërbimeve sipas kësaj Kontrate.

9.3. Asnjë interes nuk do të aplikohet mbi pagesat e mbajtura nga BMF në zbatim të kushteve të këtij neni.

## NENI 10 – PAJTUESHMËRIA ME LIGJIN NË FUQI

10.1. Palët angazhohen të zbatojnë të gjitha rregullat dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe rregulloret e politikave të BMF. Ofruesi i Shërbimit do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme që kërkohen për përmbushjen e kësaj Kontrate.

10.2. Ofruesi i Shërbimit nuk duhet të kryejë veprime të cilat janë të ndaluara nga ligjet dhe rregullat në fuqi.

## NENI 11 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me këtë Kontratë dhe që nuk mund të zgjidhet me bisedime midis Palëve, do të zgjidhet nga gjykata kompetente në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 12 - LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo Kontratë rregullohet dhe interpretohet në bazë të ligjit të Republikës së Shqipërisë.

## NENI 13 - NJOFTIMET

Çdo njoftim sipas kësaj Kontrate bëhet me shkrim dhe dërgohet në adresat e mëposhtme:

### PËR BMF:

Adresa fizike: Parku Kombëtar i Butrintit, Rr. SH81, Kodi postar 9701  
E-mail:  
Tel:

### PËR OFRUESIN E SHËRBIMIT:

Adresa fizike:  
E-mail: \_\_\_\_\_  
Tel: \_\_\_\_\_

## NENI 14 – SHTOJCAT

Palët bien dakord se Shtojca 1, Shtojca 2 dhe Shtojca 3 bashkëlidhur kësaj Kontrate janë pjesë integrale dhe të pandara të saj. Ofruesi i Shërbimit do t'i përmbahet në çdo kohë kriterëve dhe udhëzimeve të përcaktuara në Shtojcën 1, Shtojcën 2 dhe

Vendndodhja: Butrint	Tenderi № : 007/2026
Projekti: “Ndërtimi i Platformave të Ngritura dhe të Aksesueshmërisë në Parkun Kombëtar të Butrintit”	Data e publikimit: 15 Maj 2026 Data e dorëzimit: 20 Korrik 2026

Shtojcën 3.

*Kjo Kontratë u nënshkrua në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe nga Palët e mëposhtme:*

BMF

OFRUESI I SHËRBIMIT

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**SHTOJCA 1. TERMAT E REFERENCËS DHE SPECIFIKIMET E SHËRBIMIT**

**SHTOJCA 2. LEJET, LICENCAT DHE CERTIFIKIMET E OFRUESIT TË SHËRBIMIT**

**SHTOJCA 3. ÇMIMET E DETAJUARA PËR PUNIMET**